



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 shtator 2024
Nr. Ref.:AGJ 2539/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI177/22

Parashtrues

Pashk Bibaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit [AC-II-21-0058], të 23 majit 2022**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga Pashk Bibaj nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi kërkesës), i përfaqësuar nga Prek Kola, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [AC-II-21-0058] të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 2 nëntor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-II-21-0058] të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ) dhe 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 16 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 18 nëntor 2022.
8. Më 2 dhjetor 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrim të kërkesës.
9. Më 2 dhjetor 2022, Gjykata njoftoi DHPGJS-në për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
10. Më 5 dhjetor 2022, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR. KI177/22] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [nr. KSH. KI177/22] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).

11. Më 5 dhjetor 2022, DHPGJS dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar, e cila dëshmon se përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës Aktgjykimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së e ka pranuar më 2 nëntor 2022.
12. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 29 maj 2023, Gjykata kërkoj nga DHPGJS dosjen e plotë të lëndës.
14. Më 1 qershor 2023, DHPGJS dorëzoi në Gjykatë dosjen e kërkuar të lëndës.
15. Më 14 qershor 2023, Gjykata fillimisht njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe të njëjtën kohë kërkoj që ta njoftojë Gjykatën nëse parashtruesi i kërkesës ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës së Agjencisë Kosovare për Privatizim (në tekstin e mëtejshëm: AKP).
16. Më 26 qershor 2023, Gjykata Themelore dorëzoi sqarimet dhe dokumente plotësuese.
17. Më 1 gusht 2023, Gjykata i dërgoi DHPGJS-së një shkresë, përmes të cilës i kërkoj dhënien e përgjigjes apo informatave ndaj pyetjeve si në vijim:

“(i) A është njoftuar parashtruesi i kërkesës lidhur me zhvillimin e procedurës gjyqësore ndaj rastit të tij para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës?

(ii) A ka paraqitur parashtruesi i kërkesës ndonjë dokument/përgjigje në mbrojtje të rastit të tij para Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës?”
18. Më 2 gusht 2023, DHPGJS dorëzoi përgjigjet e saja ndaj pyetjeve të Gjykatës, të cilat do të pasqyrohen në vijim të këtij Aktgjykimi.
19. Më 18 janar 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesë që i njëjti të plotësohet me sqarime shtesë.
20. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
21. Më 7 maj 2024, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës së Apelit duke kërkuar përgjigje si në vijim:

“(i) Në rastin konkret, përkatësisht në lidhje me kompetencën lëndore, a ka nxjerrë gjykata e juaj vendim, përmes të cilës e ka shpallur veten jokompetente? Nëse ky është rasti, atëherë a është njoftuar parashtruesi i kërkesës në lidhje me këtë vendim?; dhe

(ii) Në vijim të kësaj, në rast të nxjerrjes së një vendimi të tillë, përmes të cilit Gjykata e Apelit ka shpallur veten jokompetente, luteni që Gjykatës t'ia dorëzoni kopjen e vendimit dhe informatën nëse parashtruesi i kërkesës është njoftuar për vendimin për transferimin e lëndës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”.
22. Më 8 maj 2024, Gjykata e Apelit dorëzoi në Gjykatë kopjen e Aktit përcjellës [Ac. nr. 5176/19] të dorëzuar në DHPGJS më 28 shtator 2021.
23. Më 6 qershor 2024, Gjykata i ktheu dosjen e rastit DHPGJS-së.

24. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata njëzëri vendosi që (i) të shpallë kërkesën e pranueshme dhe (ii) të konstatojë se Aktgjykimi [AC-II-21-0058] i 23 majit 2022 i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; dhe (iii) të kthejë Aktgjykimin [AC-II-21-0058] të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së për rivendosje sipas konstatimeve të Aktgjykimit të Gjykatës.

Përmbledhje e fakteve

25. Më 23 prill 2001, parashtruesi i kërkesës në cilësinë e blerësit dhe Kooperativa Bujqësore “Bec”, me seli në Komunën e Gjakovës – në cilësinë e shitësit, lidhën Kontratën të shitblerjes së paluajtshmërive, përkatësisht ngastrat nr. 731, nr. 732 dhe nr. 733.
26. Nga shkresat e lëndës rezulton që më 14 mars 2002, Gjykata Komunale në Pejë përmes Vendimit [Vr. nr. 2073/2002] vërtetoi Kontratën e shitblerjes (në tekstin e mëtejme: Kontrata e shitblerjes).
27. Më 3 mars 2005 dhe 5 korrik 2006, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM) kërkoi nga Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Gjakovës që mos të implementohen ndryshimet kadastrale bazuar në kontratën e shitblerjes, në emër dhe titull të parashtruesit të kërkesës.
28. Më 7 mars 2005, AKM përmes një shkrese njoftoi Kryetarin e Gjykatës Komunale në Pejë për anulimin e kontratës së lartcekur të shitblerjes, duke specifikuar se AKM administron me të gjitha ndërmarrjet në pronësi shoqërore ose publike të regjistruara ose që veprojnë në territorin e Kosovës në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.
29. Bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht sipas certifikatave mbi të drejtat pronësore të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në Komunën e Gjakovës më 4 mars 2019, përkatësisht certifikatat [nr. 459/19] lidhur me ngastrat 731-0 dhe [nr. 459/19] lidhur me ngastrën 734-0, dhe të cilat janë objekt i Kontratës, së 23 prillit 2001, të njëjtat janë lëshuar në emër të parashtruesit të kërkesës, si pronar i këtyre ngastrave.
30. Më 28 prill 2016, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), parashtrroi padë për anulimin e kontratës së kontestuar në Gjykatën Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore). AKP përmes padisë së paraqitur pretendoi se Kooperativa Bujqësore “Bec” (në tekstin e mëtejme: KB “Bec”) është ndërmarrje shoqërore e vendosur nën administrimin e AKP-së, rrjedhimisht AKP ka zotësi të plotë juridike për të marrë, mbajtur ose shitur pronën “*si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin Nr. 04/L-034 mbi AKP-në; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj*”. Ndër të tjera, AKP theksoi se në përputhje me vendimin e Bordit të AKP-së, sipas nenit 9 (Likuidimi i kryer nga Agjencia) të Ligjit 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të vitit 2011 (në tekstin e mëtejme: Ligji për AKP-në), likuidimi i ndërmarrjes KB “Bec” ka hyrë në fuqi më 9 shtator 2013 dhe se kjo ndërmarrje administrohet nga Autoriteti i Likuidimit.
31. AKP padinë e saj për anulimin e kontratës së kontestuar e arsyetoi se (i) kontrata e lidhur është në kundërshtim të plotë me Ligjin mbi AKP-në ; (ii) kontrata nuk ka bazë ligjore dhe është lidhur në kundërshtim të plotë me nenin 6 të Rregullores nr. 2000/54 të UNMIK-ut, të 27 shtatorit 2000 dhe nenin 5 të Rregullores nr. 2002/12 të UNMIK-

ut të 13 qershorit 2002; (iii) kontrata është nënshkruar nga personi i paautorizuar dhe kjo ka për pasojë pavlefshmërinë absolute të kontratës; dhe (iv) Gjykata Komunale në Pejë – që ka vërtetuar kontratën, nuk ka qenë kompetente në aspektin territorial pasi që objekti i kontratës kanë qenë ngastrat kadastrale në territorin e Gjakovës. Në vijim, AKP-ja pretendoi se: “*në bazë të nenit 86 të Ligjit për Marrëdhënie Pronësore Juridike forma e kësaj kontrate ka qenë objekt i legjislacionit të Kosovës, Ligji në fuqi, përkatësisht neni 26, pika 14 i Ligjit për gjykatat e rregullta (Gazeta zyrtar e KSAK-së 2178) ashtu se i dhe neni 13 të Ligjit të procedurës jokontestimore (Gazeta e KSAK 422/39) përcakton se për të qenë e vlefshme kontrata duhet të vërtetohej në Gjykatën Kompetente, që në rastin konkret ishte Gjykata Komunale Gjakovë, e asnjë Gjykatë tjetër, kjo kontratë është vërtetuar në Gjykatën e Pejës”, dhe “kjo gjykatë nuk ka qenë kompetente në aspektin territorial për vërtetimin e kontratës së shitblerjes pasi që objekti i kësaj kontrate janë ngastrat kadastrale të evidentuara në Brekoc pronë e KB “Bec” e cila është në Komunën e Gjakovës, rrjedhimisht është dashur që në pikëpamje ligjore e kompetencës territoriale e jo kontratë e shitjes për këto asete të vërtetohej pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë, aty ku de facto dhe de jure ndodhet pasuria dhe objekti i kontratës”. Në fund, AKP specifikoi se: “Korniza ligjore relevante pas vitit 1999, duke filluar nga 10 qershori i vitit 1999 ka përcaktuar që të gjitha pronat e luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë, janë nën administrimin e UNMIK-ut rregullorja 1999/1 neni 6 zotëruar i së drejtës së shfrytëzimit pra kësaj kohe është ai në emër të cilit gjendet prona e regjistrit publik”.*

32. Më 2 shkurt 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje ndaj padisë së AKP-së, duke kundërshtuar në tërësi padinë, me arsyetimin se (i) i njëjti, si palë laike në këtë marrëdhënie detyrimore, nuk ka pasur dhe nuk ka mundur të ketë dijeni se objekti i kontratës administrohet nga AKP; (ii) shitësi – nënshkruesi i kontratës është dashur të njoftohet nga AKP, se nuk ka kompetenca që ta tjetërsojë pasurinë e paluajtshme të KB “Bec”; (iii) Gjykata Komunale në Pejë është dashur të ketë njohuri se kontrata e tillë nuk mund të legalizohet; (iv) parashtruesi i kërkesës, duke mos pasur njohuri rreth këtyre ndalesave, në mirëbesim ka hyrë në marrëdhënien kontraktuale. Në vijim të kësaj, parashtruesi i kërkesës gjithashtu specifikoi se pas nënshkrimit të kontratës, prona në regjistrat respektiv kadastrale ishte regjistruar në emër të tij.
33. Më 2 gusht 2019, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 210/16] vendosi që të (i) refuzojë kërkesëpadinë e AKP-së si të pabazuar, përmes të cilës ka kërkuar që kontrata e vërtetuar më 14 mars 2002 të shpallet e pavlefshme; (ii) të refuzojë kërkesëpadinë e AKP-së si të pabazuar, përmes të cilës ka kërkuar të detyrohet parashtruesi i kërkesës që ngastrat kadastrale t’ia dorëzojë AKP-së në posedim; dhe (iii) detyroi AKP-në që parashtruesit të kërkesës t’i paguajë shpenzimet procedurale.
34. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit të lartcekur vërtetoi se (i) parashtruesi i kërkesës është blerës i paluajtshmërive me mirëbesim, të cilat janë objekt i kontratës; (ii) paluajtshmëritë edhe sot evidentohen në emër të parashtruesit të kërkesës; (iii) “*vet [AKP] ka neglizhuar shitjet e tilla për faktin se nuk ka mundur t’i menaxhoj ndërmarrjet pasi që fillimisht e njëjta është themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 e cila ka hyrë në fuqi me dt.13.06.2002, ndërsa kontrata është lidhur me dt.14.03.2002; (iv) “nuk dihet se [kur] Sh.A “Bec” kur është marrë në menaxhim pasi që e njëjta ka qenë e regjistruar si Shoqëri Aksionare, kurse ndërmarrjen me vendim nga AKP ka hyrë në likuidim me dt.09.09.2013, po ashtu paditësja tek në vitin 2005 me dy shkresa ka ndërmarrë veprime dhe atë duke iu drejtuar me Njoftim te dt. 07.03.2005, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Komunale në Pejë, me kërkesë për anulimin e kontratave e cila është objekt ne këtë çështje duke cekur se AKM administron me të gjitha ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore ose Publike të regjistruar ose veprojnë në territorin e Kosovës në përputhje me rregulloren e UNMIK-ut 2002/12 mbi themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” dhe (v) “Njoftimi i dt. 05.07.2006 drejtuar Drejtorit për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi në*

Gjakovë, [...] ku është cekur se ju kemi dërguar letër me dt. 03.03.2005 që mos të implementoni ndryshimet kadastrale nga kontrata në titull të z. Pashk Bibaj, e të gjitha këto veprime rrethanore pasi që nuk është njoftuar i padituri po ashtu nuk janë marrë masat ndaj menaxhmentit në ndërmarrjes (apo të paktën nuk janë prezantuar) të cilët kanë bërë shitjen e paluajtshmërisë e cila është objekt i kësaj kontrate”.

35. Më specifikisht, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore sqaron se: “[Gjykata Themelore] vërtetoi faktin se i padituri ka qenë blerës me mirëbesim dhe i njëjti i ka kryer obligimet e veta kontraktuese; (ii) paluajtshmëritë para kontratës së shitblerjes kanë qenë të evidentuara në emër të SH.A. “Bec”; dhe (iii) kjo ndërmarrje fillimisht ka formuar Komisionin për shtije, e cila ka marrë vendim se paluajtshmëritë të cilat janë objekt i kontratës së shitblerjes t’i shiten parashtruesit të kërkesës.
36. Më 16 shtator 2019, kundër Aktgjykimit [C. nr. 210/16] të Gjykatës Themelore, AKP paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
37. Më 19 shtator 2019, Gjykata Themelore i dorëzoi parashtruesit të kërkesës kopjen e ankesës së AKP-së për përgjigje në ankesë.
38. Më 16 tetor 2019, Gjykata Themelore ia dërgoi Gjykatës së Apelit dosjen e rastit, përkatësisht Aktgjykimin [C. nr. 210/16] e Gjykatës Themelore dhe ankesën e AKP-së.
39. Më 5 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigjen në ankesë, përmes të cilës kundërshtoi ankesën e AKP-së me arsyetimin se (i) pretendimet e AKP-së janë deklarative dhe të pabazuara në prova dhe fakte; (ii) AKP në asnjë moment në ankesë nuk ka potencuar shkeljet konkrete të cilat pretendon se i ka bërë Gjykata Themelore, por thirret vetëm në supozimet e saja dhe nuk ofron asnjë argument lidhur me shkeljet esenciale procedurale; si dhe (iii) Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike duke u bazuar në provat dhe faktet të cilat gjinden në shkresat e lëndës, si dhe në dëshminë e parashtruesit të kërkesës.
40. Më 6 nëntor 2019, Gjykata Themelore përcolli përgjigjen në ankesë të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën e Apelit për “veprime të mëtejme”.
41. Më 7 nëntor 2019, Gjykata e Apelit pranoi përgjigjen në ankesë të parashtruesit të kërkesës.
42. Më 28 shtator 2021, Gjykata e Apelit përmes aktit përcjellës [Ac. nr. 5176/19] dosjen e rastit e përcolli në DHPGJS, duke e konsideruar se në bazë të nenit 5 (Juridiksioni) paragrafi 4 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Ligji për DHPGJS-në), DHPGJS-ja ka kompetencë lëndore të vendosë lidhur me ankesën e AKP-së.
43. Në aktin përcjellës të Gjykatës së Apelit të dorëzuar në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, theksohet se: “Palë në procedurë në këtë çështje kontestimore janë Ndërmarrja Shoqërore ‘Bec’, me seli në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Zyra Rajonale, si-paditës dhe Pashk Bibaj nga Gjakova, si i paditur, me objekt të padisë anulimin e kontratës mbi shitblerjen dhe dorëzim të paluajtshmërisë. Ligji Nr.06/L-086, për Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që ndërlidhen me AKP-në, nenin 5, parag. 4, ka paraparë se për secilën kërkesë, lëndë, rast, apo procedurë (bashkërisht të emëruar më tutje në tekst si lëndë) të referuara tek gjykatat e tjera, para datës së hyrjes në fuqi

të këtij ligji, ajo gjykatë vazhdon kompetencën mbi lëndën derisa aktvendimet dhe aktgjykimet në lidhje me atë lëndë, i nënshtrohen shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur. Andaj, mbi bazën e të cekurave më lart, ju dorëzojmë në kompetencë të mëtejme lëndën civile Ac.nr.5176119, me të gjitha shkresat e saj, në mënyrë që të vendosni sipas ankesës së palës paditëse, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë C.nr.21 0116, të datës 02.08.2019”.

44. Më 4 tetor 2021, DHPGJS e pranoi dosjen e dorëzuar nga Gjykata e Apelit dhe rastin e regjistroi pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së me numër AC-II-21-0058.
45. Bazuar në dosjen e rastit të dorëzuar nga DHPGJS-ja rezulton që kjo e fundit nuk e kishte pranuar përgjigjen e parashtruesit të kërkesës ndaj ankesës së AKP-së.
46. Për më tepër, bazuar në përgjigjen e Gjykatës së Apelit, të dorëzuar në Gjykatë më 8 maj 2024, rezulton që parashtruesi i kërkesës gjithashtu nuk ishte njoftuar në lidhje me transferimin e rastit të tij në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
47. Më 23 maj 2022, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [AC-II-21-0058] vendosi që të (i) aprovojë ankesën e AKP-së si të bazuar; (ii) të ndryshojë Aktgjykimin [C. nr. 210/16] të 2 gushtit 2019 të Gjykatës Themelore; (iii) të anulojë kontratën e shitblerjes [Vr. nr. 2073/2002] të vërtetuar më 14 mars 2002; dhe (iv) të detyrojë parashtruesin e kërkesës që AKP-së t’ ia dorëzojë në posedim paluajtshmëritë, të cilat janë objekt i kontratës së shitblerjes.
48. Në lidhje me mbajtjen e seancës dëgjimore, Kolegji i Apelit (i) vendosi që të mos mbajë seancë gojore; dhe (ii) në lidhje me përgjigjen ndaj ankesës së AKP-së, Kolegji i Apelit specifikoi se: *“në bazë të fletëdorëzimit që ekziston në dosje, ankesën e AKP-së e ka pranuar avokati i të paditurit me datë 19.09.2019, mirëpo në dosje nuk ka dëshmi që është dhënë ndonjë përgjigje në këtë ankesë”.*
49. Përderisa, në lidhje me juridiksionin e DHPGJS-së për të vendosur mbi padinë e AKP-së, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së specifikoi se: *“Objekt kontesti është kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë lidhur me ngastrat e cekura. Këto ngastra para shitjes së tyre ishin në emër të NSH KB “BEC”, Gjakovë. Për këtë padi kishte juridiksion lëndor Gjykata Themelore në Gjakovë, e po ashtu edhe ankesa e paraqitur nga ana e paditësit ndaj Aktgjykimit të kësaj gjykate C. Nr. 210/16 të datës 02.08.2019, pa të drejtë i është drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pasi që në kohën e paraqitjes së ankesës me 16 shtator 2019, kjo Gjykatë nuk kishte juridiksion të vendos lidhur me këtë ankesë”.* Në vijim të kësaj, Kolegji i Apelit konstatoi se bazuar në nenet 5, 6 dhe paragrafin 1 të nenit 76 (Konfliktet dhe Interpretimi) të Ligjit për DHPGJS-në, DHPGJS *“ka juridiksion lëndor edhe për paditë e këtilla siç është ajo e këtij rasti.*
50. Në fund, në lidhje me meritat e ankesës, Kolegji i Apelit (i) mbështeti si të bazuara pretendimet e AKP-së për pavlefshmërinë e Kontratës së shitblerjes, të vërtetuar më 14 mars 2002 për shkak se *“në bazë të nenit 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/54 të datës 27.09.2000, e cila e plotëson dhe e ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/1 të datës 26.06.1999, Përfaqësuesi Special i UNMIK-ut ishte autoriteti i vetëm pas përfshirjes së Kosovës nën protektoratin ndërkombëtarë në qershorin e vitit 1999, që të administrojë pronat publike përfshirë edhe pronat shoqërore.”*, dhe si e tillë është lidhur në kundërshtime me dispozitat e kësaj Rregulloreje; (ii) kontrata e shitblerjes është vërtetuar nga një gjykatë jokompetente; (iii) Kolegji i Apelit nuk e konteston *“ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë e [parashtruesit të kërkesës] i cili kishte hyrë në marrëdhënie kontraktuese, duke mos i njohur paraprakisht disa fakte që ishin të rëndësishme në procesin e shitjes së këtyre pronave. Mirëpo, vetëm për shkak të*

ndershmërisë së të paditurit kontrata e shitblerjes nuk ka baza ligjore të mbettë në fuqi në bazë të ligjit që ishte në fuqi në kohën e lidhjes së saj”. Dhe nëse [parashtruesi i kërkesës] e ka paguar çmimin e kontraktuar në bazë të kësaj kontrate siç pohon ai, gjë që për këtë në dosje të lëndës nuk ka dëshmi, ai është e qartë se del i dëmtuar nga kjo marrëdhënie kontraktuese. Mirëpo, ai ka mundësi që në një procedurë të veçantë gjyqësore të kërkoj kompensimin dhe kthimin e mjeteve të paguara nëse kjo ka ndodhur”.

i) Përgjigjja e Gjykatës Themelore në Gjakovë, e dorëzuar më 26 qershor 2023

51. Më 26 qershor 2023, Gjykata pranoi përgjigjet në pyetjet e Gjykatës nga Gjykata Themelore në Gjakovë.
52. Lidhur me pyetjen nëse parashtruesi i kërkesës ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës së AKP-së në Gjykatën e Apelit, Gjykata Themelore sqaroi si në vijim: (i) ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, të 2 gushtit 2019, AKP më 16 shtator 2019 paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit; (ii) më 19 shtator 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka pranuar ankesën e AKP-së; (iii) *“Meqenëse pala ka afat prej 7 ditësh për të parashtruar ankesë dhe nuk e ka bërë këtë në bazë të aktit shoqëruar të datës 16.10.2023, shihet se gjykata lëndën së bashku me të gjitha shkresat e saja, përfshirë edhe ankesën, ia ka dërguar për vendosje Gjykatës së Apelit”.* (iv) Gjykata e Apelit lëndën e dorëzuar nga Gjykata Themelore e ka pranuar më 18 tetor [2019]; (iv) më 5 nëntor 2019, përfaqësuesi ligjor i parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore ka paraqitur përgjigje në ankesë; (v) Gjykata Themelore përgjigjen në ankesë Gjykatës së Apelit ia ka dorëzuar më 6 nëntor 2019, dhe kjo e fundit këtë përgjigje e ka pranuar më 7 nëntor 2019; dhe (vi) *“Lidhur me vendimin e shkallës së dytë se a është përfshirë përgjigjja në ankesë, ne nuk mund ta analizojmë, pasi që është vendim i shkallës së dytë, sa i përket procedurës në si gjykatë i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat janë në kompetencën tonë”.*

ii) Përgjigjja e Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme, e dorëzuar me 2 gusht 2023

53. Më 2 gusht 2023, DHPGJS ndaj pyetjes nëse parashtruesi i kërkesës është njoftuar në lidhje me transferimin e rastit në DHPGJS, kjo e fundit u përgjigj si në vijim:

“Në lidhje me kërkesën tuaj lidhur me lëndën AC-II-21-0058, ju njoftojmë se lëndën origjinale se bashku me shkresat përcjellëse është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese me datë 01.06.2023”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

54. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [AC-II-21-0058] i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i 23 majit 2022, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
55. Parashtruesi i kërkesës thekson se pas dorëzimit të lëndës në DHPGJS: *“[...] ne si palë e paditur asnjëherë nuk jemi njoftuar për rrjedhën e kësaj procedure dhe nuk është dhënë mundësia që në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme të paraqesim prova dhe faktet që shkojnë në favor të paditurit në mënyrë që të krijohet barazia e armëve dhe kundërshtimit procedural”.*
56. Lidhur me anulimin e kontratës, parashtruesi i kërkesës thekson se: *“Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij ka anuluar Kontratën VR.nr.2073/2002 të dt.14.03.2002, pra kjo kontratë nuk është e specifikuar drejt në Aktgjykimin e lartcekur se kur është lidhur kjo kontratë pasi sipas kontratës është dt.23.04.2001 dhe e përpiluar me*

dt.20.04.2001 dhe e vërtetuar nga Gjykata e Qarkut në Pejë më dt.28.02.2002, pra nga kjo gjendje faktike nuk dihet se për cilën kontratë bëhet fjalë pasi datat janë të ndryshme, dhe ky aktgjykim në këtë formë nuk mund të prodhojë efekt juridik pasi është në kundërshtim me gjendjen faktike reale sipas kontratës”.

57. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se “[...] konsiderojmë që ky Aktgjykim është i përfshirë me shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës për një gjykim të drejtë, sepse Kolegji i Apelit është dashur të hapë seancë shqyrtimi për shkak të ndryshimit të kompetencave dhe ndryshimit të Aktgjykimit në dëm të paditurit që i njëjti t’i paraqesë pretendimet e tij lidhur me faktet dhe provat të cilat ka vendosur Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme që secila palë të jetë e barabartë në procedurë”.
58. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës thekson se “Shkeljet tjera procedurale janë sepse i padituri nuk është njoftuar me kohë me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit [Ac-II-21-0058] edhe pse në këtë procedurë ka pasur të angazhuar av. Prek Kola nga Gjakova, me autorizim në shkresë të lëndës, ky Aktgjykim i ka prekur të drejtat e paditurit edhe pa u njoftuar me vendimin gjyqësor deri me dt.02.11.2022”.
59. Në fund, parashtruesi i kërkesës thekson: “ne si palë e paditur asnjëherë nuk jemi njoftuar për rrjedhën e kësaj procedure dhe nuk është dhënë mundësia që në Kolegjin e Apelit të Gjykatës Supreme të paraqesim prova dhe faktet që shkojnë në favor të paditurit në mënyrë që të krijohet barazia e armëve dhe kundërshtimit procedural”.

Dispozita relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

“1.Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.

[...]

Ligji Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore

Neni 5 (pa titull)

“5.1 Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.

5.2 Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka drejtë që të vendos mbi kërkesën për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet”.

Neni 187 (pa titull)

“187.1 Një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mundet, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë.

187.2 Një ekzemplar të përgjigjes në ankesë gjykata e shkallës së parë ia dërgon ankuesit menjëherë, ose më së voni brenda afatit shtatë ditor nga arritja e saj në gjykatë.

[...]”

Neni 188 (pa titull)

“188.1 Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë, nëse është paraqitur me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë ditësh më së shumti.

188.2 Po që se ankuesi pretendon se në procedurën e shkallës së parë janë shkelur dispozitat e procedurës kontestimore, gjykata e shkallës së parë mund të jep shpjegime lidhur me thëniet në ankesë që i përkasin shkeljeve të tilla, e sipas nevojës mund të bëjë hetime me qëllim të verifikimit të saktësisë së thënieve përkatëse në ankese”.

LIGJI Nr. 06/L – 054 PËR GJYKATAT

Neni 26 Kompetencat e Gjykatës Supreme

1. Gjykata Supreme është kompetente të vendosë lidhur me:

[...]

1.6. në Dhomën e Posaçme, lëndët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ose të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, siç parashihet me ligj;

**LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME
TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË
PRIVATIZIMIT**

**Neni 5
Juridiksioni**

1. Dhoma e Posaçme ka kompetencë ekskluzive mbi gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me fushat në vijim:

1.1. kundërshtimi ndaj një vendimi apo ndonjë veprimi tjetër nga AKM-ja apo Agjencia, ndërmarrë në bazë të Rregullores së AKM-së, apo përkatësisht në bazë të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

1.2. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë të cilat rrjedhin nga dështimi apo refuzimi i AKM-së apo Agjencisë për të kryer një akt apo për të përmbushur një obligim që kërkohet me ligj apo kontratë;

1.3. kërkesa kundër AKM-së apo Agjencisë për humbjet financiare që pohohen të jenë shkaktuar nga një vendim a veprim i ndërmarrë nga AKM-ja apo Agjencia, në bazë të autoritetit administrativ të përcaktuar me Rregulloren e AKM-së apo Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, në lidhje me një Ndërmarrje apo Korporatë;

1.4. kërkesa kundër një Ndërmarrjeje apo Korporate që pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së, apo Agjencisë;

1.5. kërkesa që pretendojnë një të drejtë, titull apo interes në lidhje me:

1.5.1. çfarëdo pasurie apo prone mbi të cilën Agjencia apo AKM-ja ka apo ka shpallur autoritetin administrativ;

1.5.2. pronësinë e një Ndërmarrjeje apo Korporate;

1.5.3. pronësinë mbi kapitalin e një Ndërmarrjeje apo Korporate, ose

1.5.4. çfarëdo prone apo pasurie në posedim apo kontroll të një Ndërmarrjeje apo Korporate, nëse një e drejtë, titull apo interes i tillë pohohet të ketë lindur gjatë apo para kohës kur ajo Ndërmarrje apo Korporatë i është nënshtruar autoritetit administrativ të AKM-së apo Agjencisë;

1.6. kërkesa apo ankesa që kundërshtojnë apo sfidojnë cilindo aspekt të një liste zyrtare të punëtorëve me të drejtë legjitime të një Ndërmarrjeje, lëshuar nga AKM-ja apo Agjencia, sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo legjislacionit pasardhës që rregullon përpilimin e listave të tilla;

**Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë**

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysht çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.

2. Gjatë seancës dëgjimore me gojë, Kolegji i Apelit kryesohet nga gjyqtari kryesues. Kryesuesi është përgjegjës për mbarëvajtjen e seancës. Në fillim të çdo seance dëgjimore, Kryesuesi përcakton praninë e palëve dhe avokatëve të tyre.

3. Pala që përfaqësohet në seancë përmes avokatit, mund t'i drejtohet Kolegjit të Apelit vetëm përmes atij, përveç nëse ndonjë anëtar i Kolegjit të Apelit ia parashtron asaj pale një pyetje drejtpërdrejt

4. Pas hapjes së seancës me gojë, gjyqtari kryesues paraqet një hyrje të shkurtër të ankesës, çështjeve ligjore të kontestuara dhe çfarëdo gjetje faktike të konstatuar nga vendimmarrësi i Aktvendimit apo Aktgjykimit gjegjë, për të cilin pala pretendon se është "qartazi i pasaktë".

5. Në dëgjimin me gojë, palëve mund t'u jepet mundësia për të bërë një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre ligjore. Palët kufizojnë prezantimet e tyre në faktet dhe provat që pasqyrohen në shënimet që janë të rëndësishme për ankesën dhe çështjet ligjore që janë të rëndësishme për ankesën. Kolegji i Apelit mund të caktojë një afat të arsyeshëm kohor për secilën palë për prezantimet e tilla.

6. Përveç nëse lejohet në mënyrë të veçantë në bazë të nenit 70 të këtij ligji, gjyqtari(ët) nuk do të nis procedurat për vlerësimin e provave.

7. Procesmbajtësi kujdeset që procesverbali fjalë-për-fjalë i të gjitha seancave mbahet dhe regjistrohët nga raportuesi i gjykatës. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga Kryesuesi.

Neni 70

Paraqitja e provave të reja

Në rrethana të jashtëzakonshme dhe për arsye që dëshmojnë mirë, Kolegji i Apelit mund t'i lejoj një pale paraqitjen e provave të reja që nuk kanë qenë në dispozicion të palës gjatë procedurës së shkallës së parë për vlerësimin e provave. Kërkesa me shkrim për një leje të tillë duhet së pari t'i dorëzohet Kolegjit të Apelit dhe duhet t'i dorëzohet palëve tjera jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së seancës kur propozohet paraqitja e këtyre provave. Kolegji i Apelit mund të autorizojë paraqitjen e provave të reja nëse vlerëson se në këtë mënyrë drejtësia do të vihet në vend.

Neni 76

Konfliktet dhe interpretimi

1. Dispozitat e këtij ligji mbizotërojnë mbi secilën dispozitë që nuk përputhet me të në cilëndo rregullore, ligj apo akt tjetër nënligjor. Megjithatë, në rast të ndonjë konflikti mes këtij ligji dhe Ligjit nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre apo të legjisllacionit pasardhës të saj (cilido që të jetë në fuqi në atë kohë), ky i fundit do të mbizotërojë.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Kryetari i Gjykatës Supreme në bashkëpunim me Gjyqtarin Mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme dhe me Administratorin pa vonesë ndërmarrin hapat e nevojshëm për riorganizimin e punës pranë gjyqtarëve të vetëm dhe Kolegjeve të Apelit si dhe caktimin e menjëhershëm të lëndëve tek gjyqtarët.

3. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

60. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

61. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.[...]"

Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

62. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

63. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-II-21-0058] e 23 majit 2022 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
64. Gjykata gjithashtu konstaton se kërkesa i plotëson kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me paragrafin 1 të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. E njëjta nuk mund të shpallet e papranueshme mbi bazën e kushteve të përcaktuara përmes paragrafit 3 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
65. Për më tepër, dhe në fund, Gjykata thekson se kërkesa nuk mund të shpallet e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Prandaj, ajo duhet deklaruar e pranueshme dhe duhet të vlerësohen meritat e saj.

Meritat

66. Gjykata fillimisht rikujton se rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me atë se parashtruesi i kërkesës dhe Kooperativa Bujqësore “SH.A. Bec” në vitin 2001 kishin lidhur kontratën, të regjistruar në Gjykatën Komunale në Pejë më 14 mars 2002 me numër [V. nr. 2073/2002] për shitblerjen e paluajtshmërive, pronë e “SH.A. Bec”. Më 3 mars 2005 dhe 5 korrik 2006, AKM në Zyrën Kadastrale në Gjakovë kishte paraqitur kërkesë për mosimplementimin, përkatësisht mosregjistrimin e paluajtshmërive në emër të parashtruesit të kërkesës. Më 28 prill 2016, AKP në Gjykatën Themelore në Gjakovë kishte paraqitur padi, përmes të cilës kishte kërkuar shpalljen e pavlefshme të kontratës së shitblerjes dhe dorëzimin e paluajtshmërive në posedim të AKP-së, me arsyetimin se kontrata e shitblerjes ishte lidhur dhe vërtetuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe në kundërshtim me rregullat për shitjen e asetëve të ndërmarrjeve shoqërore. Në anën tjetër, ndaj padisë së AKP-së kishte parashtruar përgjigje në padi, përmes të cilës kundërshtoi pretendimet e AKP-së duke pretenduar se kontrata e shitblerjes është lidhur në pajtim me dispozita e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Në vijim të padisë së parashtruar nga ana e AKP-së, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 210/16] të 2 gushtit 2019 kishte refuzuar kërkesëpadinë e AKP-së me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës *“është blerës i paluajtshmërive të cilat janë objekt i kontratës”*. Kundër këtij vendimi, AKP më 16 shtator 2019, paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit. Në lidhje me këtë, nga shkresat e lëndës rezulton që parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur përgjigje ndaj ankesës së AKP-së. Megjithatë, nga shkresat e lëndës rezulton që më 16 tetor 2019, Gjykata Themelore dosjen e rastit, përfshirë Aktgjykimin [C. nr. 210/16] e Gjykatës Themelore dhe ankesën e AKP-së e kishte dorëzuar në Gjykatën e Apelit. Në ndërkohë, më 5 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje ndaj ankesës së AKP-së, të cilën Gjykata Themelore më 6 nëntor 2019 ia përcolli Gjykatës së Apelit. Në vijim të kësaj, më 28 shtator 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktit përcjellës [Ac. nr. 5176/19] drejtuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së deklaroi se bazuar në paragrafin 4 të nenit 5 (Juridiksioni) të Ligjit për DHPGJS-në, kjo e fundit ka kompetencë lëndore që të vendosë lidhur me ankesën e AKP-së, dhe si rezultat i kësaj i dorëzoi edhe dosjen e rastit, që përfshinte ankesën e AKP-së, por duke mos përfshirë përgjigjën e parashtruesit të kërkesës ndaj ankesës së AKP-së. Po ashtu, bazuar në shkresat e lëndës, të pranuar nga DHPGJS, po ashtu edhe nga Gjykata e Apelit, rezulton që parashtruesi i kërkesës nuk ishte njoftuar në lidhje me transferimin e lëndës në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Si rezultat i transferimit të çështjes në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kjo e fundit përmes Aktgjykimit [AC-II-21-0058], pasi konstatoi kompetencën lëndore në lidhje me padinë e AKP-së, aprovoi ankesën e AKP-së si të bazuar dhe ndryshoi Aktgjykimin [C. nr. 210/16] e Gjykatës Themelore të 2 gushtit 2019.
67. Në vijim të konstatimeve të lartcekura, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij në Gjykatë konteston Aktgjykimin [AC-II-21-0058] e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar, në esencë shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak se si rezultat i mos njoftimit nga ana e instancave gjyqësore për transferimin e çështjes së tij në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, atij i (i) ishte pamundësuar paraqitja e provave në favor të tij dhe (ii) po ashtu i ishte pamundësuar që të kërkojë mbajtjen e seancës dëgjimore në këtë instancë gjyqësore. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata vëren se bazuar në paragrafin 1 të nenit 69 (Procedurat e ankesës me gojë) të Ligjit për DHPGJS-në përcaktohet që: *“Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.*

68. Gjykata, marrë për bazë rrethanat e rastit konkret dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës në kërkesën e tij në Gjykatë, vlerëson se pretendimet e tij ndërlidhen me parimin e kontradiktoritetit në procedurë gjyqësore dhe të drejtën e tij për t'u dëgjuar, si pjesë përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.

A. Parimet e përgjithshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës

69. Rrjedhimisht, në vlerësimin e pretendimeve të lartcekura, Gjykata do të shtjellojë (i) parimet e përgjithshme përkitazi me (a) parimin e kontradiktoritetit dhe (b) të drejtën për një seancë dëgjimore të garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret, për të vazhduar me (ii) aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret. Këto kategori pretendimesh, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
70. Gjykata bazuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, fillimisht e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura të Kushtetutës, dhe të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtarë; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, në mënyrë të ngjashme, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës *KI42/16*, me parashtrues *Valdet Sutaq*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 nëntorit 2016, paragrafi 41; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: *KI128/19*, me parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; *KI22/19*, parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; dhe *KI148/21*, me parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafi 58).
71. Bazuar në të lartcekurat, Gjykata rithekson rëndësinë e drejtës për një proces kontradiktor, si pjesë përbërëse e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, në përputhje me të cilin palët duhet të kenë mundësinë jo vetëm që të bëjnë të ditur ndonjë dëshmi të nevojshme për të pasur sukses në pretendimet e tyre, por gjithashtu të kenë njohuri dhe të kenë mundësi të komentojnë të gjitha dëshmitë e prezantuara në çështjen e që mund të kenë ndikim në vendimin e Gjykatës dhe është në kompetencë të gjykatave që të informojnë dhe ju mundësojnë palëve ndërgjyqëse qasje në informata (shih, ndër të tjera, rastet GJEDNJ-së *Krčmář dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 35376/97, Aktgjykim i 3 marsit 2000, paragrafi 40; *Nideröst-Huber kundër Zvicrës*, nr. 18990/91, Aktgjykim i 18 shkurtit 1997, paragrafi 24; dhe *Mantovanelli kundër Francës*, nr. 21497/93, Aktgjykim i 18 marsit 1997, paragrafi 33; dhe rastin e Gjykatës *KI159/17*, me parashtrues *Ismet Miftari*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 prillit 2019).
72. Në vijim të kësaj, Gjykata duke vendosur theksin në pretendimin thelbësor të parashtruesit të kërkesës e që ndërlidhet me të drejtën për mbajtjen e seancës dëgjimore, vë në dukje se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vendosur parimet themelore përkitazi

me të drejtën për një seancë dëgjimore. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata gjithashtu ka përcaktuar parimet dhe përjashtimet përkatëse, bazuar në të cilat vlerësohet domosdoshmëria e mbajtjes së një seance dëgjimore, varësisht nga rrethanat e rasteve përkatëse. Në vijim të kësaj, përmes një numri aktgjykimesh, Gjykata ka vënë theks në këto parime, duke konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore para DHPGJS-së, përkatësisht edhe para Kolegjit të Specializuar edhe Kolegjit të Apelit (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KI145/19](#), [KI146/19](#), [KI147/19](#), [KI149/19](#), [KI150/19](#), [KI151/19](#), [KI152/19](#), [KI153/19](#), [KI154/19](#), [KI155/19](#), [KI156/19](#), [KI157/19](#) dhe [KI159/19](#), me parashtrues *Et-hem Bokshi dhe të Tjerët*, Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020; [KI160/19](#), [KI161/19](#), [KI162/19](#), [KI164/19](#), [KI165/19](#), [KI166/19](#), [KI167/19](#), [KI168/19](#), [KI169/19](#), [KI170/19](#), [KI171/19](#), [KI172/19](#), [KI173/19](#) dhe [KI178/19](#), me parashtrues *Muhamet Këndusi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 27 janarit 2021; [KI181/19](#), [KI182/19](#) dhe [KI183/19](#), me parashtrues *Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi*, Aktgjykim i 27 janarit 2021; [KI220/19](#), [KI221/19](#), [KI223/19](#) dhe [KI234/19](#), me parashtrues *Sadete Koca Lila dhe të tjerët*, Aktgjykim, i 25 marsit 2021; dhe [KI186/19](#); [KI187/19](#), [KI200/19](#) dhe [KI208/19](#), me parashtrues *Belkize Vula Shala dhe të tjerët*; Aktgjykim, i 28 prillit 2021 dhe [KI01/20](#), me parashtrues *Momir Marinković*, Aktgjykim, i 29 korrikut 2021).

B. Vlerësimi i Gjykatës

73. Ashtu siç u theksua edhe më lart, në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të fokusohet në pretendimin e parashtruesit të kërkesës për të kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore para Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, e mundësuar sipas dispozitave të Ligjit për DHPGJS-në si rezultat i mosnjohimit të transferimit të çështjes në Kolegjin e Apelit në DHPGJS.
74. Ashtu siç është specifikuar edhe në pjesën e procedurës para Gjykatës, si rezultat i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës dhe në dritën e procedurës së zhvilluar para gjykatave të rregullta, Gjykata i ka kërkuar këtyre të fundit, specifikisht edhe Gjykatës së Apelit nëse parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar në lidhje me transferimin e çështjes së tij në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, megjithatë Gjykata e Apelit përveç dorëzimit të Aktit Përcjellës të transferimit të çështjes në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së nuk dorëzoi informatë specifike në Gjykatë nëse parashtruesi ishte njoftuar në lidhje me transferimin e lëndës. Për më tepër, bazuar edhe në dosjen e plotë të lëndës nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së po ashtu nuk rezulton që parashtruesi i kërkesës nga kjo instancë gjyqësore ishte njoftuar se çështja që ndërlidhej me kërkesëpadinë dhe ankesën e AKP-së, respektivisht në të cilën parashtruesi i kërkesës ishte palë e paditur ishte transferuar në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
75. Prandaj, në dritën e të lartcekurave dhe bazuar në parimet e shtjelluara më lart, Gjykata në vijim fillimisht duhet të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret, fakti që parashtruesi i kërkesës nuk kishte mundësi të kërkonte mbajtjen e seancës dëgjimore, të mundësuar përmes paragrafit 1 të nenit 69 (Procedurat e ankesës me gojë) të Ligjit për DHPGJS-në atij i ka shkelur të drejtën e tij për të paraqitur argumentet dhe dëshmitë përkatëse në favor të tij.
76. Gjykata fillimisht vë në dukje se bazuar në dispozita e LPK-së, e që ndërlidhen me kompetencën lëndore, ndaj vendimeve apo akteve përcjellëse të gjykatave të rregullta për transferimin e lëndëve në gjykata tjera, në këtë rast në DHPGJS, nuk rezulton që palët të parashtrorj në mjetet juridike. Për më tepër, bazuar në paragrafin 4 të nenit 5 të Ligjit të lartcekur për DHPGJS-në, përcaktohet që: *“Për secilën kërkesë, lëndë, rast apo procedurë (bashkërisht të emëruara më tutje në tekst si: “lëndë”) të referuar tek gjykatat e tjera para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, ajo gjykatë vazhdon të ketë kompetencë mbi lëndën, derisa aktvendimet dhe aktgjykimet në lidhje me atë lëndë i*

nënshtrohen shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme me kushtin e parashtrimit me kohë të parashtrësës nga pala apo pala e tretë e prekur”.

77. Në kuptim të kësaj të fundit, përkatësisht në lidhje me juridiksionin e DHPGJS-së për të vendosur mbi padinë e AKP-së, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit të saj kishte theksuar se: *“Objekt kontesti është kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë lidhur me ngastrat e cekura. Këto ngastra para shitjes së tyre ishin në emër të NSH KB “BEC”, Gjakovë. Për këtë padi kishte juridiksion lëndor Gjykata Themelore në Gjakovë, e po ashtu edhe ankesa e paraqitur nga ana e paditësit ndaj Aktgjykimit të kësaj gjykate C. Nr. 210/16 të datës 02.08.2019, pa të drejtë i është drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, pasi që në kohën e paraqitjes së ankesës më 16 shtator 2019, kjo Gjykatë nuk kishte juridiksion të vendos lidhur me këtë ankesë”.* Në vijim të kësaj, Kolegji i Apelit konstatoi se bazuar në nenet 5, 6 dhe paragrafin 1 të nenit 76 (Konfliktet dhe Interpretimi) të Ligjit për DHPGJS-në, DHPGJS *“ka juridiksion lëndor edhe për paditë e këtilla siç është ajo e këtij rasti”.*
78. Thënë këtë, Gjykata nuk vë në diskutim detyrimin e përcaktuar me dispozitën e lartcekur, bazuar në të cilën Gjykata e Apelit e transferoi lëndën në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Megjithatë, në rrethanat e rastit, ashtu siç është pretenduar edhe nga vetë parashtruesi i kërkesës, kontestuese është detyrimi që parashtruesi i kërkesës të njoftohej në lidhje me transferimin e çështjes së tij në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, në mënyrë që ai të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore në këtë instancë të DHPGJS-së ashtu siç përcaktohet me nenin 69 të Ligjit për DHPGJS-në.
79. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 69 të Ligjit për DHPGJS-në përcakton që: *“Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim”.*
80. Në vijim, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton që: *“Pas hapjes së seancës me gojë, gjyqtari kryesues paraqet një hyrje të shkurtër të ankesës, çështjeve ligjore të kontestuara dhe çfarëdo gjetje faktike të konstatuar nga vendimmarrësi i Aktvendimit apo Aktgjykimit gjegjësisht, për të cilin pala pretendon se është “qartazi i pasaktë”. Përderisa paragrafi 5 i nenit 69 të Ligjit, në kuptim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve palëve i mundëson ofrimin e “[...] një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre ligjore. Palët kufizojnë prezantimet e tyre në faktet dhe provat që pasqyrohen në shënimet që janë të rëndësishme për ankesën dhe çështjet ligjore që janë të rëndësishme për ankesën. Kolegji i Apelit mund të caktojë një afat të arsyeshëm kohor për secilën palë për prezantimet e tilla”.*
81. Ngjashëm edhe bazuar në dispozitat e Ligjit për DHPGJS-në, në fuqi që nga viti 2019, dhe i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se bazuar në nenin 66 (Përmbajtja e ankesës) dhe nenin 70 (Paraqitja e provave të reja) të këtij ligji, palët, ndër të tjera, kanë mundësinë që të ngritin ankesat para Kolegjit të Apelit edhe përkitazi me çështjet e ligjit dhe të fakteve, duke përfshirë edhe mundësinë që të paraqiten prova të reja dhe për pasojë Kolegji i Apelit ka kompetencën e vlerësimit të çështjeve të ligjit dhe të faktit, dhe të kompetencës së plotë për të vlerësuar mënyrën se si i ka vlerësuar faktet autoriteti më i ulët, në rastin konkret të parashtruesit të kërkesës, Gjykata Themelore. Për pasojë, Gjykata vlerëson se është e pakontestueshme që çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit, nuk është (i) as çështje ekskluzivisht ligjore; dhe (ii) as e natyrës teknike. Përkundrazi, çështja në shqyrtim para Kolegjit të Apelit ngërthente çështje të rëndësishme faktike dhe ligjore.

82. Në kuptim të kësaj të fundit, Gjykata merr në konsideratë faktin që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore duke refuzuar kërkesëpadinë e AKP-së kishte vendosur në favor të parashtruesit të kërkesës, përderisa si rezultat i transferimit të çështjes në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së nga ana e Gjykatës së Apelit, përmes Aktgjykimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, kërkesëpadia e AKP-së ishte pranuar si e bazuar, dhe për pasojë kontrata e shitblerjes ishte anuluar si e pavlefshme duke e detyruar parashtruesin e kërkesës që paluajtshmëritë objekt i kontratës së shitblerjes dhe tashmë të regjistruara në emër të tij t'ia dorëzonte në posedim AKP-së.
83. Gjykata, duke iu rikthyer konstatimeve të Kolegjit të Apelit përmes Aktgjykimit të saj, vëren se në lidhje me mbajtjen e seancës dëgjimore, Kolegji i Apeli kishte (i) vendosur që të mos mbajë seancë gojore; dhe (ii) në lidhje me përgjigjen ndaj ankesës së AKP-së, Kolegji i Apelit kishte konstatuar se: “[...] në bazë të fletëdorëzimit që ekziston në dosje, ankesën e AKP-së e ka pranuar avokati i të paditurit me datë 19.09.2019, mirëpo në dosje nuk ka dëshmi që është dhënë ndonjë përgjigje në këtë ankesë”.
84. Në lidhje me të parën, Gjykata gjithashtu vë theks në faktin se Kolegji i Apelit nuk kishte arsyetuar *“heqjen dorë nga seanca”*, por ishte mjaftuar vetëm me referimin në nenin 69 të Ligjit për DHPGJS-në. Ky i fundit, siç është sqaruar më lart, thjesht përcakton kompetencën e Kolegjit të Apelit për të vendosur për mbajtjen e seancës dëgjimore bazuar në nismën e tij ose me kërkesë të palës. Aktgjykimi përkatës nuk përmban asnjë sqarim shtesë lidhur me vendimin e Kolegjit të Apelit për *“të hequr dorë nga seanca”*. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në vlerësimin e pretendimeve që ndërliken me mungesën e një seance dëgjimore, duhet të shqyrtohet edhe nëse refuzimi i mbajtjes së një seance të tillë është i arsyetuar (shih, edhe rastet e GJEDNJ-së, [Pönkä kundër Estonisë](#), kërkesa nr. 64160/11, Aktgjykim, i 8 nëntorit 2016, paragrafët 37-40 dhe [Mirovni Institut kundër Sllovenisë](#), nr. 32303/13), Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 44 dhe referencat e përdorura aty).
85. Në vijimin e të dytës, bazuar në përgjigjet e Gjykatës Themelore, rezulton që si rezultat i ankesës së AKP-së, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar përgjigje në ankesë, e cila nuk ishte pjesë e dosjes së dorëzuar nga Gjykata e Apelit në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Në lidhje me këtë, Gjykata pa paragjykuar nëse përgjigjja ndaj ankesës së AKP-së nga ana e parashtruesit të kërkesës ishte dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me ligj apo jo, gjithsesi e njëjta në kuptim të respektimit të parimit të kontradiktoritetit, përfshirë këtu edhe respektimin e parimit të barazisë së armëve, si pjesë përbërëse të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, kjo përgjigje do duhej të ishte pjesë e dosjes, për të cilën Kolegji i Apelit të DHPGJS-së duhej të ofronte vlerësimin dhe konstatimin e saj, përfshirë këtu edhe konstatimin në kuptim të pranueshmërisë së saj apo dorëzimit të përgjigjes ndaj ankesës brenda afatit të përcaktuar me ligj.
86. Gjykata në vijim të elaborimit të parimeve dhe standardit të zhvilluar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, të afirmuar edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës dhe shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, në kuptim të së drejtës për mbajtjen e seancës dëgjimore e që ndërliken ngushtë me parimin e kontradiktoritetit, konstaton se në rrethanat e rastit konkret parashtruesi i kërkesës (i) nuk e konteston apo vë në pikëpyetje juridiksionin apo kompetencën lëndore të DHPGJS-së për të vendosur në lidhje me ankesën e AKP-së (ii) megjithatë, në kuptim të parimit të kontradiktoritetit konstaton se parashtruesit të kërkesës i është pamundësuar apo mohuar e drejta për të kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore, si rezultat i mosnjoftimit të transferimit të çështjes së tij në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se Aktgjykimi i kontestuar, përkatësisht Aktgjykimi [AC-II-21-0058] të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, është nxjerrë në kundërshtim me parimet dhe garancitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, e që ka

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 4 shtator 2024, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, se Aktgjykimi [AC-II-21-0058] i 23 majit 2022, i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË SHPALLË TË PAVLEFSHËM, Aktgjykimin [AC-II-21-0058] të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- IV. TA KTHEJË, Aktgjykimin [AC-II-21-0058] të 23 majit 2022, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për rivendosje sipas konstatimeve të Aktgjyimit të Gjykatës;
- V. TË URDHËROJË Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që ta njoftojë Gjykatën, në pajtim me rregullin 60 (5) të Rregullores së punës, deri më 4 mars 2024, për masat e ndërmarra për zbatimin e Aktgjyimit të Gjykatës;
- VI. TË MBETET e përkushtuar në këtë çështje në pajtim me këtë urdhër;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- VIII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Bayram Ljatifi



Gresa Caka-Nimani